



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA  
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

C.nr.179 /09

**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS** si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi , në çështjen juridike të paditësit: tani të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson , kundër të paditurës: nga Mitrovica, baza e kontestit: Lirim paluajtshmërie dhe pagesë borxhit pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 17.04.2013 në prani të palëve ndërgjyqëse gjykata me dt. 30.04.2013, nxjerr këtë:

### A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht padia dhe kërkesëpadia e paditëses e Kosovës tani me të cilën ka kërkuar që ta obligon të paditurën që t'ia liron pronën e cila evidentohet në emër të të paditëses sipas certifikatës së pronësisë me numër të ngashtës 03504-2 dhe t'ia paguajë paditëse në emër të qirasë shumë prej 3.329.20 euro.
- II. **OBLIGOHET**, e paditura që brenda 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi t'ia lirojë paditëses pronën nga njerëzit dhe sendet nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale
- IV. Pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses refuzohet si e **PA BAZË**

### A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj ka parashtruar në gjykatë padi me të cilën ka kërkuar nga gjykata që ta obligon të paditurin që t'ia liron pronën e uzurpuar si dhe t'ia paguajë në paditëse shumë prej 3 329 20 euro sipas precizimit përfundimtar të padisë.

E paditura deklaroi se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses me pretendimin se ajo dhe familja e saj jetojnë në atë vend që më tepër se 60 vite , konsideron se shtëpia është e saj ndërsa për këtë tokë ka paguar edhe tatim në pronë.

Në seancë kryesore përfaqësuesi i paditëses deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiës si dhe pranë parashtrësës mbi plotësimin e kërkesëpadiës.

E paditura deklaroi se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, e njoftoi gjykatën se qiranë nuk ka mundësi ta paguajë, për shkak të gjendjes ekonomike si dhe i dorëzoi gjykatës prova që vërtetojnë se familja e të paditurës është që një kohë të gjatë në atë nisë



Në procedurën e provave gjykata administroi këto prova: flesën e dërguara nga ana e paditëses e dt.26.05.2009, deklarata e bërë në emër të të paditurës : , deklarata e bërë nga paditësja në drejtim të drejtorit të paditëses me emrat e personave të cilët paditësja pretendon se ia kanë uzurpuar, kontrata mbi qiranë e dt.18.09.2009, urdhëresa për lirim të pronës e dt.10.07.2009, urdhëresa e paditëses e dt.22.09.2009, certifikata mbi të drejtat e pronës e dt.16.03.2009 me numër UL-71208072-03304, fatura e tatimit në pronë e dt.18.03.2013, fatura e ujit e viteve 1995,96 dhe 1997, dëftesa e shërbimit të kontabilitetit shoqëror i dt.14.07.1990, faturat e energjisë elektrike të viteve 1995,99,98, fatura e lëshuar nga Hekurudhat e Kosovës e dt.08.07.1997, procesverbali mbi mbajtjen e ankandit publik për shitjen e kullosave e vitit 1998, aktvendimi lëshuar nga Departamenti i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale me nr. Dosjes 6026, fatura e tatimit në pronë të pas luftës dhe faturat e KEK-ut e vitit 2006.

Provat e administruara gjykata i vlerësoi konform nenit 7 dhe 8 të LPK-së, dhe pas bindjes së lirë erdhi në këto përfundime:

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se paditësja është pronare e pronës në fjalë, e cila vërtetohet nga certifikata e pronësisë,

Nuk është kontestues se e paditura dhe familja e saj më herët kanë banuar dhe vazhdojnë të banojnë në atë vend një gjë të tillë e pranon edhe vet e paditura dhe se nga provat tjera e sidomos faktuar një gjë e tillë vërtetohet në mënyrë të plotë.

Nuk është kontestues fakti se paditësja ka ndërmarr veprime të caktuara për të mbrojtur pronën e saj, kjo më së miri vërtetohet nga urdhëresat për lirim të pronës të cilat paditësja ia ka dërguar të paditurit, pastaj ofrimi i kontratës mbi qiranë.

E paditura me asnjë provë të vetme nuk e dëshmoi të drejtën e saj pronësore, nuk ngriti në këtë qështje kundërpadi për vërtetim pronësie, ndërsa sipas Ligjit Për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore E drejt e ndërtimit si formë e fitimit të pronësisë nuk parashihet.

Përkundrazi e paditura me provat e ofruara sidomos me faturat e vitit 1997 fakturat lëshua nga paditësja veq se dëshmoi të drejtën e pronësisë së paditëses, dhe forcoi bindjen e gjykatës për këtë gjë, pasi këto fatura janë paguar nga ana e familjarëve të të paditurës në emër të shfrytëzimit të banesës, apo vendit të banimit.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lartë gjykata vlerësoi se janë plotësuar kushtet për aprovimin e pjesërishtëm të padisë në fjalë.

Sa i përket pjesës tjetër të kërkesëpadisë rreth pagimin të borxhit që e kërkon paditësja e që mbështetet në kontratën mbi qiranë të cilën paditësja ia ka ofruar të paditurit, gjykata konsideron se konform nenit 15 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve kontrata është e lidhur kur palët kontraktues janë marrë vesh për elementet thelbësore të saj.

Në rastin konkret nga kontrata shihet qartë se i paditurit nuk e ka nënshkruar, kontratën në fjalë, po ashtu nga deklarata e të paditurit se nuk ka pas mundësi me pagua atë shumë dhe konform dispozitës së lartpërmendur kontrata nuk është lidhur në mes të palëve dhe se një kontratë e tillë nuk prodhon kurrfarë efekti juridik në mes të palëve.

Andaj edhe duke u bazuar në këtë fakt gjykata konsideron se në mes të paditëses dhe të paditues nuk ka pasur kurrfarë raporti kontraktual dhe se nuk ekziston detyrimi i kërkuar nga ana e paditëses.

Gjykata konform nenit 450 të LPK-së vendosi si në dispozitiv sa i përket shpenzimeve të procedurës, pasi që asnjëra nga palët nuk i kërkuan shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi që secila palë ti bart shpenzimet e veta procedurale.

Aktgjykimi bazohet në nenin 143, par.1 të LPK .

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.179/09 të dt.30.04.2013**



**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK** : Kundër këtij aktgjykimi lejohet e drejta në ankesë, brenda afatit 15 ditor, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.